REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. Prot. 06-02/898/21
Nr. i faq. 06
Data 17-03-2021

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 12.03.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti AKK–DPKI-06-2961/20, lidhur me Konkursin Nr. Prot. 2/262 të datës 23.10.2020, për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021, në Fakultetit Juridik të Universitetin të Prishtinës "Hasan Prishtina", për programin "E Drejta Penale", për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi lidhur me Konkursin Nr. Prot. 2/262 të datës 23.10.2020, për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021, në Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në vijim: UPHP), për programin "E Drejta Penale", është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga një palë e tretë (raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet, projekt propozimet ideore kanë qenë të shënuara me emër dhe mbiemër të secilit kandidat dhe të bashkangjitura në dosjet e aplikimit, së bashku me të gjitha dokumentet identifikuese (certifikata e lindjes, CV etj.), dhe se kandidatët për student në studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik të UPHP-së, janë intervistuar nga komisioni i përbërë nga profesorë të këtij fakulteti, ndërkaq kandidati me inicialet B. J. i renditur me numër rendor tre (3), në tabelën e rezultateve për doktorantë në fushën e të drejtës penale, është asistent i Fakultetit Juridik, që i bie se kolegët (profesorët) e kanë vlerësuar kolegun (asistentin).

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka kërkuar nga UPHP-ja dokumentacion dhe informata shtesë lidhur Konkursin Nr. Prot. 2/262 të datës 23.10.2020, për Fakultetin Juridik të UPHP-së (shkresa zyrtare: DPKI-06-02/71/21). Agjencia ka pranuar nga UPHP-ja përgjigjen së bashku me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara (shkresa zyrtare: DPKI-06-02/71-1/21).

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit, informatat, sqarimet dhe dokumentacionin e pranuar nga UPHP-ja lidhur me këtë rast, përfshirë legjislacionin relevant në fuqi, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Senati i UPHP-së ka shpallë Konkursin publik Nr. Prot. 2/262 të datës 23.10.2020, për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021. Konkursi është hapur në pesë programe të Fakultetit Juridik të UPHP-së, për gjithsej tetëmbëdhjetë pozita për studentë të rregullt dhe pesë pozita për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë. Prej të cilave për programin "E Drejta Penale" janë paraparë katër pozita për studentë të rregullt dhe një pozitë për kandidatët nga komunitetet jo-shumicë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 02.11.2020 deri më datë 09.11.2020.

Me Vendimin Nr. Prot. 02/85 të datës 03.11.2020, Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së ka emëruar Këshillin e Studimeve të Doktoratës të Fakultetit Juridik, në përbërje prej pesë anëtarëve. Ndërsa, me Vendimin Nr. Prot. 2/984 të datës 27.11.2020, Senati i UPHP-së ka emëruar Këshillin Qendror për Studimet e Doktoratës të UPHP-së, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve.

Me Vendimin Nr. Prot. 03/515 të datës 20.11.2020, Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së ka emëruar Komisionin pranues për zbatimin e konkursit, në përbërje prej pesë anëtarëve. Paragrafët 4 dhe 5 të këtij vendimi, përcaktojnë obligimin e anëtarëve të Komisionit pranues për deklarim të situatave të konfliktit të interesit në raport me kandidatët që kanë aplikuar, si dhe obligimin për t'u tërhequr nga vlerësimi dhe vendimmarrja në rast se ekziston konflikti i interesit.

Me Vendimin Nr. Prot. 03/517 të datës 20.11.2020, Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së ka emëruar Komisionin për hartimin e pyetjeve për provimin pranues, ashtu që për secilin nga pesë programet për Fakultetin Juridik, janë emëruar komisionet në përbërje prej tre anëtarëve. Edhe në këtë vendim është përcaktuar obligimi i anëtarëve të komisioneve përkatëse për deklarim dhe shmangie të papërshtatshmërisë dhe konfliktit të interesit në raport me kandidatët.

Për më tepër, me e-mailin e datës 20.11.2020, Dekani i Fakultetit Juridik ka dërguar listën e kandidatëve që kanë aplikuar dhe që do t'i nënshtrohen provimit pranues, tek të gjithë anëtarët e Komisionit për hartimin e pyetjeve për provimin pranues dhe ka kërkuar prej tyre të deklarojnë nëse kanë konflikt të interesit me ndonjërin nga kandidatët. Sipas përgjigjes së Dekanit të Fakultetit Juridik të UPHP-së drejtuar Agjencisë, asnjë anëtarë i komisionit për hartimin e pyetjeve për provimin pranues, nuk është deklaruar për konflikt eventual të interesit.

Në konkursin e shpallur për Fakultetin Juridik, për programin "E Drejta Penale" kanë aplikuar gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë, ndërsa provimit pranues i janë nënshtruar pesëmbëdhjetë (15) prej tyre, sepse njëri nga kandidatët nuk ka plotësuar kriteret formale të konkursit dhe është diskualifikuar nga Komisioni pranues.

Pas mbajtjes së provimit me shkrim dhe intervistës me gojë, më datë 02.12.2020, Komisioni pranues ka nxjerrë Raportin Nr. Prot. 02/216, për zbatimin e konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik dhe ka shpallë rezultatet preliminare.

Sipas listës me rezultatet preliminare të konkursit, e cila është shpallë në uebfaqen e zyrtare të Fakultetit Juridik, në programin "E Drejta Penale" janë pranuar katër kandidatë të rregullt. Në numrin rendor tre (3) të listës së kandidatëve të pranuar për këtë program është z. Bashkim Jupolli, i cili sipas informatave të cilat gjinden në uebfaqen zyrtare të Fakultetit Juridik, është Asistent në Katedrën Penale të këtij fakulteti.

Kundër vendimit, përkatësisht kundër listës së rezultateve preliminare të shpallura nga Komisioni pranues, si organ i shkallës së parë, janë parashtruar dymbëdhjetë (12) ankesa, të cilat i ka shqyrtuar Komisioni i Studimeve të Doktoratës i Fakultetit Juridik, i cili vepron si organ i shkallës së dytë për trajtimin e ankesave për pranim në studimet e doktoratës.

Pas shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Studimeve të Doktoratës ka paraqitur Raportin Nr. Prot. 02/117 të datës 09.12.2020, së bashku me vendimet për trajtimin e ankesave të kandidatëve për regjistrim në studimet e doktoratës.

Më pas, me shkresën Nr. Prot. 02/119 të datës 11.12.2020, Dekani i Fakultetit Juridik i ka paraqitur Senatit të UPHP-së, propozimin për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2020/21 (rezultatet preliminare) sipas konkursit, së bashku me raportin e Komisionit pranues dhe raportin e Komisionit për Studimet e Doktoratës të Fakultetit Juridik.

Përveç kësaj, Dekani i Fakultetit Juridik me shkresën Nr. Prot. 02/123 të datës 21.12.2020, drejtuar Rektorit dhe Prorektorit për kërkime shkencore të UPHP-së, ka konfirmuar se gjatë procesit të implementimit të konkursit të doktoratës në Fakultetin Juridik, nuk ka pasur dukuri të nepotizmit dhe konfliktit të interesit, dhe se në këtë proces janë zbatuar normat dhe parimet e kodit të etikës. Me këtë shkresë, Dekani i Fakultetit Juridik ka sqaruar të gjitha veprimet që ka ndërmarrë menaxhmenti i Fakultetit Juridik, në secilën fazë të zbatimit të konkursit, për të deklaruar dhe shmangur nepotizmin dhe konfliktin e interesit, nga të gjithë anëtarët e komisioneve përkatëse në raport me kandidatët që kanë aplikuar.

Me Vendimin Nr. Prot. 4/12 të datës 29.12.2020, paragrafi 1, pika d), Senati i UPHP-së, me rekomandim të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, ka aprovuar listën me kandidatët e propozuar nga Fakulteti Juridik, për pranim në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/21. Si rrjedhojë, Fakulteti Juridik më datë 26.01.2021, ka shpallë në uebfaqen zyrtare listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar në studimet e doktoratës, e cila listë sa i përket programit "E Drejta Penale", nuk ndryshon nga lista e rezultateve preliminare.

Nga shkresat në dispozicion, Agjencia ka evidentuar një sërë veprimesh dhe masash që ka ndërmarrë menaxhmenti i Fakultetit Juridik të UPHP-së, për deklarimin, shmangien dhe parandalimin e situatave të konfliktit të interesit, lidhur me zbatimin e konkursit. Fillimisht, me pikën (13) e konkursit përfshirë sqarimin e kësaj pike nga Senati i UPHP-së, ka qenë i përcaktuar obligimi për shmangie të nepotizmit dhe konfliktit të interesit. Më pas, me të gjitha vendimet e Fakultetit Juridik për themelimin e komisioneve për zbatim të konkursit, është paraparë obligimi i anëtarëve të këtyre komisioneve për deklarim dhe shmangie të situatave të konfliktit të interesit. Poashtu, menaxhmenti i Fakultetit Juridik, në të gjitha fazat e zbatimit të konkursit, ka kërkuar nga

anëtarët e komisioneve përkatëse deklarimin dhe shmangien e situatave të mundshme të konfliktit të interesit.

Nga shkresat në dispozicion, nuk është evidentuar se ndonjëri nga anëtarët e komisioneve të ketë deklaruar se ka pasur konflikt të interesit, në lidhje me çështjen që ka trajtuar apo në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar apo që janë pranuar.

Me qëllim të sqarimit të pretendimit për situatë të mundshme me konflikt të interesit për kandidatin z. Bashkim Jupolli, përkatësisht për sqarimin e pjesëmarrjes së tij eventuale në diskutim dhe vendimmarrje, lidhur me procesin e pranimit të studentëve në studimet e doktoratës sipas konkursit, Agjencia ka kërkuar nga Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së dokumentacion dhe informata shtesë (shkresa zyrtare: DPKI-06-02/328/21). Duke vepruar sipas kërkesës së Agjencisë, Dekani i Fakultetit Juridik të UPHP-së ka dërguar përgjigjen së bashku me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara (shkresa zyrtare: DPKI-06-579/21).

Sipas ekstraktit nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Juridik të UPHP-së, e mbajtur më datë 04.06.2020, në të cilën mbledhje, ndër të tjera është aprovuar propozimi për numrin e studentëve që do t'i propozohen Senatit të UPHP-së për hapjen e konkursit për studimet e doktoratës, konstatohet se z. Bashkim Jupolli nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë mbledhje e rrjedhimisht nuk ka marrë pjesë në diskutimet dhe vendosjen (çastet paraprake të vendimmarrjes) për hapjen e konkursit të studimeve të doktoratës.

Ndërsa, sipas ekstraktit nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Juridik të UPHP-së, e mbajtur më datë 11.11.2020, në të cilën janë formuar komisionet për zbatimin e konkursit, konstatohet se z. Bashkim Jupolli nuk ka qenë pjesëmarrës në këtë mbledhje e rrjedhimisht nuk ka marrë pjesë në diskutimet dhe vendosjen për formimin e Komisionit pranues dhe Komisionit për hartimin e pyetjeve për provimin pranues. Për më tepër z. Bashkim Jupolli, nuk ka qenë pjesë e asnjë komisioni për zbatimin e konkursit për pranimin e studentëve në doktoratë.

Përveç asaj që u konstatua më lartë, Agjencia ka caktuar dhe mbajtur një takim me z. Bashkim Jupolli, në zyrat e Agjencisë, me ç'rast i njëjti është njoftuar për pretendimet e raportuesit të rastit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Z. Bashkim Jupolli, në takimin e mbajtur ka konfirmuar se është staf akademik (asistent) i Fakultetit Juridik të UPHP-së, por ka sqaruar se nuk ka qenë dhe nuk është anëtar i Këshillit të Fakultetit Juridik, dhe se nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të diskutimeve apo vendimmarrjes në fakultet lidhur me konkursin për doktoratë. I njëjti ka deklaruar se nuk është person i afërm me asnjërin nga anëtarët e komisioneve që kanë zbatuar konkursin.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia ka konstatuar se pranimi i kandidatit z. Bashkim Jupolli në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/21, në Fakultetin Juridik të UPHP-së, në programin "E Drejta Penale", duke qenë se i njëjti është staf akademik (asistent) në Katedrën Penale të këtij fakulteti, nuk përbënë konflikt të interesit. Kjo ngase, siç është konstatuar më lartë, në cilësi të Asistentit të Fakultetit Juridik, z. Bashkim Jupolli nuk ka qenë pjesë e mbledhjeve të Këshillit të Fakultetit Juridik kur është diskutuar dhe vendosur për formimin e komisioneve dhe për çështjet tjera që lidhen me zbatimin e konkursit, si dhe nuk ka qenë pjesë e

komisioneve që kanë zbatuar këtë konkurs. Rrjedhimisht, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në këtë rast.

Në anën tjetër, fakti se profesorët e Fakultetit Juridik kanë qenë pjesë e komisioneve për zbatimin e konkursit, me ç'rast kanë vlerësuar aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar për t'u pranuar në studimet e doktoratës, në mesin e tyre edhe vlerësimi i z. Bashkim Jupolli i cili është pjesë e stafit akademik në Fakultetin Juridik, nuk bie ndesh me nenin 6 dhe nenin 17 paragrafi 1, lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.6 të LPKI-së.

Së këndejmi, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".*

Tutje me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

Me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së është përkufizuar se: "*interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste."* Ndërsa me nënparagrafin 1.6 të këtij neni është përkufizuar se: "*person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".*

Në rastin konkret, në kuptim të dispozitave të sipërshënuara, nuk është gjetur se ndonjëri nga anëtarët e komisioneve për zbatim të konkursit të Fakultetit Juridik, në procesin e pranimit të studentëve në studimet e doktoratës, të ketë pasur interes privat për çështjen në të cilën kanë marrë pjesë si anëtar i komisionit përkatës dhe se z. Bashkim Jupolli që është pranuar në studimet e doktoratës në programin "E Drejta Penale", nuk konsiderohet person i afërm i tyre.

Kjo ngase, siç është konstatuar më lartë, asnjëri nga anëtarët e komisioneve në asnjë rast nuk është deklaruar se ka pasur konflikt të interesit, në lidhje me çështjen që kanë trajtuar apo në lidhje me kandidatët që kanë aplikuar apo që janë pranuar, edhe pse menaxhmenti i Fakultetit Juridik, ka kërkuar nga anëtarët e komisioneve deklarimin dhe shmangien e situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Poashtu një obligim i tillë për anëtarët e komisioneve ka qenë i përcaktuar me pikën (13) e konkursit dhe në sqarimin e kësaj pike nga Senati i UPHP-së, si dhe me vendimet e Fakultetit Juridik për themelimin e komisioneve.

Andaj, fakti se profesorët e Fakultetit Juridik në cilësi të anëtarëve të komisioneve përkatëse për zbatim të konkursit, kanë marrë pjesë në hartimin e pyetjeve për provimin pranues, vlerësimin e

kandidatëve dhe shqyrtimin e ankesave të kandidatëve, në mesin e të cilëve ka qenë z. Bashkim Jupolli, i cili është pjesë e stafit akademik të Fakultetit Juridik, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit. Kjo ngase profesori i fakultetit dhe asistenti i fakultetit, nuk konsiderohen persona të afërm në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së. Sepse raporti profesor – asistent, nuk është raport që cilësohet si *'person i afërm me zyrtarin'* sipas dispozitës së sipërshënuar.

Përveç kësaj, pranimi i stafit akademik të fakultetit në studimet e doktoratës në të njëjtin fakultet, përveç se nuk ndalohet me dispozitat e akteve normative të UPHP-së, një gjë e tillë konsiderohet përparësi. Kështu me dispozitën e nenit 7, paragrafi 4, nënparagrafi 6, të Rregullores së UPHP-së për studimet e doktoratës Nr. Prot. 1/775 të datës 09.09.2014, është përcaktuar se me rastin e vlerësimit të kandidatëve për pranim në studimet e doktoratës *"Në kushte të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së"*.

Agjencia ka shqyrtuar këtë rast, në kuadër të pretendimeve të raportuesit të rastit, vetëm në aspekt të vlerësimit nëse paraqet konflikt të interesit fakti që profesorët kanë qenë pjesë përbërëse e komisioneve për zbatimin e konkursit në Fakultetin Juridik, me ç'rast kanë vlerësuar asistentin e këtij fakulteti i cili është pranuar në studimet e doktoratës në programin "E Drejta Penale".

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit